



Pranuar / Dërguar Punëdhënësi/Pratfitor Received/Delivered	12.02.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot Bil. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBATCH	612/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.443/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.443/2020, të datës 30.12.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në fshatin "Shtedim" Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 12.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.443/2020 e datës 30.12.2020 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke bërë kompensimin e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për ankuesin**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Komunën e Podujevës, me datë 30.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3360/2020 të regjistruar me numër A.nr.443/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 05.01.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës. Këshilli, me datë 20.01.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.443/2020 të datës 30.12.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Formularin e ankesës të datës 19.11.2020; Ankesën e datës 19.11.2020 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër të protokollit 13/104/02-0074027/20 të datës 04.12.2020 të Komisionit për Ankesa në Komunën e Podujevës; Formularin për ankesë të datës 27.10.2020; Kërkesën e datës 27.10.2020 drejtuar Zyrës së personelit lidhur me kompensimin në rastin e vdekjes së anëtarit të familjes; Përgjigjen në kërkesën e datës 27.10.2020; Dokumentin e Identifikimit të ankuesit; Certifikatën e datës 26.10.2020; Shkrese përcjellës e datës 07.12.2020; Akt Emërimit e datës 01.02.2017; Vendimin e datës 11.09.2020 për Themelimin e Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik; Vërtetimin me Nr.235 të datës 18.01.2021; Deklaratën me NR 11025211 të bashkësisë familjare; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.01.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 20.01.2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Akt Emërimit e datës 01.02.2017, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme" në Komunën e Podujevës.

Me datë 27.10.2020, ankuesi i është drejtuar Menaxherit të Personelit në Komunën e Podujevës, me kërkesë për kompensimin e një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, gjegjësisht babait, mirëpo kërkesa e ankuesit është refuzuar nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Podujevës.

Ankuesi i pa kënaqur me përgjigjen e Menaxherit të Personelit, me datën 19.11.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Komunës së Podujevës. Komisioni i Ankesave me datë 04.12.2020 ka nxjerr vendim me të cilin është shpallur jo kompetent, duke drejtuar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 të Ligjit Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se Komisioni i Ankesave pran Komunës së Podujevës ka zbatuar drejtë ligjin material me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.13-104/02-0074027/20 të datës 04.12.2020 për shpalljen e tij jo kompetent për vendosje lidhur me çështjen e ankuesit.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil; si dhe dispozitat e Rregullores

Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Mbi këtë bazë, duke iu referuar shkresave të lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes V 10360410 të datës 26.10.2020, të dorëzuar nga ankuesi, Kolegji ka konstatuar se Mustafa Maloku, gjegjësisht babai i ankuesit, ka ndërruar jetë me datë 23.02.2020, ndërsa bazuar në Vërtetimin Nr.235 të Drejtorisë së Administratës të Komunës së Podujevës, Kolegji ka konstatuar se i ndjeri ka jetuar në bashkësi familjare me ankuesin deri në ditën e vdekjes, kështu që duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së babait është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.443/2020.

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Jefon KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës, dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së